Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Lulzim Bajrami	**05.12.2023**	**06.12.2023**	**2023/0979**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.12.2023, OE "**HIDRO PROJECT SH.P.K**."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0979, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së te dates 20.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndertimi i QKMF ne Istog" me nr. të prokurimit: "206-23-6380-5-1-2",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të kufizuar, lloji i kontrates: punë, vlera e parashikuar e kontrates: **2,431,353.85 €**.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së Qëllimi Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 33 i LPP-së Procedurat e hapura dhe të kufizuara Neni 56 i LPP-së Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 60 i LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës Neni 69 i LPP-së Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 8 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik Neni 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Neni 47 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Autoriteti kontraktues/Ministria e Shëndetësisë me dt. 26.06.2023 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i QKMF në Istog, kontratë pune me vlerë të madhe dhe procedurë të kufizuar. Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues për tenderues të kualifikuar/eliminuar është publikuar me dt. 20.11.2023 ku janë kualifikuar gjithsejtë pesë operator ekonomik (nuk është arritur maksimumi i lejuar prej 6 operatorëve ekonomik).

Grupi i operatorëve ekonomik Hidro Project Shpk&Engroup Shpk/përkatësisht ne jemi eliminuar nga gara e mëtutjeshme gjegjësisht nuk jemi kualifikuar më tutje për fazën tjetër. Arsyeja e eliminimit të grupi tonë është si më poshtë: Nuk e keni prezantuar inxhinierin me certifikatë të efiqencës së energjisë sipas kërkesës 3 te kapacitetit teknik dhe profesional në NjK dhe DT-nuk keni ofruar asnjë dokument për dëshmi.

Sa i përket kësaj arsye të eliminimit, ju konfirmojmë se ne e plotësojmë këtë kërkesë plotësisht dhe këtë e argumentojmë me dëshmi konkrete. Kërkesa Nr.3 tek neni 9.1&9.2 përkitazi me kapacitetin teknik dhe profesional ka qenë si më poshtë:

Kërkesa

3. Stafi profesional – Inxhinier ose Master – Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se posedon me staf profesional të nevojshëm (min. 6 inxhinier) për realizimin e projektit. Së paku njëri prej tyre te dëshmoj se ka udhëhequr punime në lëmin e efiçencës së energjisë. 3.1 Një - Menaxher i Projektit – Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës ose Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve ndërtimore. 3.2 Një Inxhinier kryesor i punishtes – Inxhinier i Operativës në teren – Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – Konstruktiv, së paku 5 vite përvojë profesionale në udhëheqjen e projekteve ndërtimore. 3.3 Një Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës, së paku 5 vite përvojë profesionale në fushën e ndërtimit. 3.4 Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – Hidroteknik, së paku 5 vite përvojë pune profesionale në fushën e ndërtimit. 3.5 Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës, së paku 5 vite përvojë pune profesionale në fushën e ndërtimit. 3.6 Një Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë, së paku 5 vite përvojë pune profesionale në fushën e ndërtimit.

Dëshmia dokumentare

3. Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur - Certifikata për efiçence të energjisë, për njërin nga inxhinierët e kërkuar. Diplomat e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master), CV-t e nënshkruara nga vet inxhinieret, Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt, Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës, gjithashtu, për Menaxherin e projektit si dëshmi kërkohet - Vendim për caktimin e Menaxherit te projektit.

Pra dëshmi dokumentare është kërkuar që njëri nga inxhinierët të jetë i certifikuar për efiçiencë të energjisë. Ne si grup i operatorëve ekonomik "Hidro Project Shpk&Engroup Shpk me rastin e ofertimit gjegjësisht me dosje kemi bashkangjitur listën e stafit profesional të liderit Hidro Project në përbërje prej 8 inxhinierëve, e ku në numrin rendor 2 është inxhinierja znj.Arberesha Kastrati. Për inxhinieren Arberesha Kastrati ne kemi bashkangjitur me dosje, Diplomën e masterit të noterizuar dhe kontratën e punës për projektin në fjalë, mirëpo tani e kemi vërejt se për shkak të një lëshimi teknik nuk kemi bashkangjitur certifikatën për auditim të energjisë në ndërtesa. Pra ka qenë një lëshim teknik nga ana jonë me rastin e bashkëngjitjes së dokumentacionit. Këtë certifikatë e kemi bashkangjitur në projektin tjetër të zhvilluar nga ana juaj "Ndërtimi i QKMF në Drenas" dhe këtë mund ta vërtetoni nëse analizoni dokumentet

tona në këtë tender (si dëshmi që ka ekzistuar kjo certifikatë para datës së fundit të dorëzimit të aplikacioneve).

Si dëshmi se inxhinierja Arberesha Kastrati ka certifikatën për auditim të energjisë në ndërtesa, po ju bashkëngjisim me këtë kërkesë për rishqyrtim certifikatën e trajnimit. Certifikata në fjalë mban datën para datës së hapjes së ofertave, konkretisht trajnimi nga inxhinierja në fjalë është mbajtur nga 28 shtator deri me dt.09.12.2020. Autoritet kontraktues është dashur te veproj në harmoni me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe në harmoni me nenin 8 të Rregullores Nr.001/2022 Për prokurim publik dhe të kërkon sqarime shtesë në lidhje me mungesën e certifikatës së inxhinieres Arberesha Kastrati, ashtu sic keni kerkuar sqarime shtese per ISO Strandartet 9001; sipas rregullores eshte dashur qe te kerkohet sqarimi shtese per certifikate dhe cv dhe me pas te behet vleresimi

Mungon Certifikata e numrit fiskal	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon licenca	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon certifikata ISO	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
Mungon çmimi	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund te kërkohen informata sqaruese	69

Meqenëse nuk janë zbatuar dispozitat e lartpërmendura me rastin e vlerësimit të aplikacioneve atëherë me mirëkuptim kërkojmë nga ana juaj që të merret parasysh certifikata e trajnimit për auditim të energjisë në ndërtesa e znj. Arberesha Kastrati. Kjo certifikatë duhet të merret parasysh sepse i plotëson kushtet sipas nenit 72.3 të LPP-së, pasi që mund të vërtetohet në mënyrë objektive ekzistenca e saj.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT
MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA E KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Universiteti i Prishtinës Universit
"Hasan Prishtina" "Hasan Pr

QENDRA PËR ENERGJI DHE QËNDRU
CENTER FOR ENERGY AND SUSTAI

CERTIFIKATË

Arbëresha Kastrati

Përfundoj me sukses trajnimin për Auditor lidhur me

Auditimin e energjisë në ndërtesa

në Prishtinë, në periudhën 28 Shtator deri më 09 dhjetor 2020

Trajnimi është financuar nga Qeveria Gjermane nëpërmjet Deutsche Gesellsch
Interantionale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Nenin 72 i LPP-së:

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike,

autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës".

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65- 71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Certifikata në fjalë, bënë pjesë në kuadër të dëshmive prej nenit 65-71, ku lejohen të kërkohen sqarime dhe plotësime, konkretisht certifikata bënë pjesë në kuadër të kualifikimeve shkollore dhe profesionale në kuadër të nenit 69 të LPP-së, prandaj sipas këtyre dispozitave është dashur të kërkohen sqarime dhe plotësime në lidhje me këto dëshmi. Nga prezantimi i dëshmisë/përkatësisht certifikatës së inxhinieres Arberesha Kastrati, vijmë në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i aplikacioneve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, si dhe nuk janë zbatuar dispozitat e nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, prandaj me mirëkuptim kërkojmë që të zbatohen këto dispozita me rastin e rishqyrtimit të kësaj kërkesë për rishqyrtim dhe të kualifikohemi në fazën tjetër.

Duke marr për bazë të gjitha sqarimet dhe dëshmitë konkrete vijë në përfundim se nuk është respektuar edhe dispozita e nenit 47 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik sepse nuk jemi kualifikuar për fazën tjetër edhe pse i kem i plotësuar të gjitha kërkesat e fletës së të dhënave për para kualifikim të dokumentit para kualifikues. Neni 56.2.2 e përcakton qartë se numri maksimal i kandidatëve të para kualifikuar është 6, prandaj në këtë rast është edhe një vend i zbrazët për tu plotësuar numri maksimal prej 6 kandidatëve. Po ashtu neni 47.17. i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik e përcakton që numri maksimal i kandidatëve të para kualifikuar është 6, kurse në njoftimin mbi vendimin shihet se janë para kualifikuar pesë operator ekonomik, e që domethënë për tu arritur numri maksimal i tenderuesve të para kualifikuar mund të përfshihet edhe një tenderues, e në këtë rast ne i plotësojmë të gjithë kërkesat e përshtatshmërisë dhe kërkesat minimale për kualifikim, prandaj duhet të jemi tenderuesi i 6 i kualifikuar në këtë rast. Njëkohësisht nuk është marr në konsideratë edhe neni 7 i LPP-së, pasi që paragrafi 1 i këtij neni e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Konsiderojmë se ne jemi diskriminuar në këtë fazë parakualifikuese, prandaj kërkojmë që të respektohen të gjitha dispozitat e LPP-së dhe të merret parasysh certifikata e trajnimit për auditim të energjisë në ndërtesa e znj. Arberesha Kastrati Në fund kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e grupit të OE "Hidro Project Shpk&Engroup Shpk".

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe lënda te kthehet në

RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i aplikacioneve të bëhet në harmoni me Fletën e Të Dhënave Për Para kualifikim (FDP) dhe sipas dispozitave të LPP-së dhe të para kualifikohemi në fazën tjetër.

Po ashtu neni 59.2 i LPP-së parasheh i më poshtë: "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të ti j, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve

Pra, të gjitha këto dispozita ligjore lejojnë dhe parashohin mundësinë e sqarimeve dhe plotësimeve të dokumenteve të munguara, prandaj edhe ju si autoritet kontraktues është dashur të veproni në këtë mënyrë.

Natyrisht që këto dispozita duhet të përdoren në harmoni edhe me nenin 7 të LPP-së përkitazi me trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomik.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kritert e përcaktuara ne Dosjen e tenderit dhe sipas LPP-së

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

Ne si komision i vlerësimit prej 17 ofertave kemi përzgjedhur 5 prej tyre te cilat i rekomandojmë qe te hyjne ne rrethin e ngus

3. Grup I Operatorëve Ekonomik TERMOMONTIMI; N.N. 100 % Design Sh.p.k.; Haxha Kom SH.P.K.; Rexha, Numri fiskal Prishtine

6. Grup i Operatorëve Ekonomik AAG PROJEKT; Shkembi Sh.p.k.; Enggroup SH.P.K.; ALPING SH.P.K., Numri fiskal: A Nr.82/7 PRISHTINË

9. ALFA.i, Numri fiskal: 810298853 rr. Ibrahim Rugova pn. Lipjan

10. Grup i Operatorëve Ekonomik Valmir Loshi B.I.; Benita Company, GURRAKOC, ISTOG

12. Grup i Operatorëve Ekonomik CONSTRUMAX SH.P.K.; TOP PROJEKT SH.P.K.; HARST Group SH.P.K., Numri fiska Krasniqi p.n. Bukosh Suharekë

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

O.E. është palë interesi për pjesemarrje ne këtë procedurë

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Nuk ka pasur

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **HIDRO PROJECT SH.P.K.**

Pretendimi ankimor i operatorit ekonomik është mos kualifikimi i tyre ne fazen tjetër te procedures me qerast është eliminuar për arsyejn:

ARSYETIM

Nuk e keni prezantuar Inxhinierin me Certifikate te efiqences se energjisë sipas kërkesës 3 te Kapaciteti teknik dhe profesional ne NJK dhe DT - nuk keni ofruar asnjë dokument për dëshmi.

AK-Ministria e Shëndetësis ne **DOKUMENTI I PARAKUALIFIKIMIT** për procedurën e kufizuar , **Faza e Parë** tekë kërkesa:

Kapaciteti teknik dhe professional ka kërkuar

Kërkesa 3. Stafi profesional

Inxhinier ose Master – Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se posedon me staf profesional të nevojshëm (min. 6 inxhinier) për realizimin e projektit. Së paku njëri prej tyre te dëshmoj se ka udhëhequr punime në lëmin e efiçencës së energjisë.

3.1.Një - Menaxher i Projektit – Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës ose Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve ndërtimore. 3.2 Një Inxhinier kryesor i punishtes – Inxhinier i Operativës në teren – Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – Konstruktiv, së paku 5 vite përvojë profesionale në udhëheqjen e projekteve ndërtimore. 3.3 Një Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës, së paku 5 vite përvojë profesionale në fushën e ndërtimit. 3.4 Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – Hidroteknik, së paku 5 vite përvojë pune profesionale në fushën e ndërtimit. 3.5 Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës, së paku 5 vite përvojë pune profesionale në fushën e ndërtimit. 3.6 Një Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë, së paku 5 vite përvojë pune profesionale në fushën e ndërtimit.

Dëshmia 3.

Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur - Certifikata për efiçence të energjisë, për njërin nga inxhinierët e kërkuar. Diplomat e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master), CV-t e nënshkruara nga vet inxhinieret, Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt, Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës, gjithashtu, për Menaxherin e projektit si dëshmi kërkohet , Vendim për caktimin e Menaxherit te projektit.

Operatorit ekonomik i pa kënaqur nadaj eliminimit te kuaifikmit te tij per fazate tjera te vleresimit me daten 24.11.2023 ka parashturua kërkes për rishqyrtim pran AK, i njeti ka paraqiur dëshmit e kërkuara nga AK ne Dokumentin e Parakualifikimit për ing.e prezantuar znj.Arbëresha Kastrati.

AK-MSH, me daten 30.11.2023 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si te pa bazuar me aryetimet si ne vijim:

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin ankimore te OE ankues:

Nuk qendron pretendimi juaj rreth inxhinieres znj. Arberesha Kastrati, meqense certifikata për efiçencë te energjisë, ka qene qartë e specifikuara ne NJK dhe DT, kërkesa 3 te Kapaciteti teknik dhe profesional, dhe si e tille është dashtë te plotësohet nga secili ofertues ose GOE, ju nuk e keni ofruar ne ofertën tuaj.

Gjithashtu per znj. Arberesha Kastrati ne oferten tuaj mungon edhe CV e inxhinieres, e kërkuar për ta dëshmuar përvojën 5 vjeçare qe është kërkuar ne NJK dhe DT.

Sa i përket njoftimit tuaj se këtë certifikatë e keni bashkangjitur në projektin tjetër të zhvilluar nga MSh, ne nuk e kemi vërejtur një gjë te tille, ajo mund ta vërtetohet, por secili projekt trajtohet ndarasi.

Ne lidhje me oferten tuaj ka paraqitur pretendime edhe OE tjeter ankues, prej te cilave vlen te theksohet se inxh. i Makinerise i ofertes tuaj z. Ramadan Gashi, diplomen si master e ka me 16.01.2020 dhe nuk e ka eksperiencen e kërkuar prej 5 vite përvoje pune pas diplomimit, siç është kërkuar ne NJK dhe DT. Gjithashtu nga OE tjeter ankues janë evidentuar mangesi edhe te pajisjet e kërkuara sipas kriterit nr. 5 te NJK dhe DT.

Duke pasur parasysh këto kërkesa operatori ekonomik ne oferten e tij ka prezantuar **Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur,Diplomat e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master),Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt, lidhur me ing.znj.Arbëresha Kastrati,** por i njeti nuk ka pezantuar dokumentet , **Certifikata për efiçence të energjisë, CV-t e nënshkruara nga vet inxhinieret,Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës.**

Lista e ing.e dorzuar nga Operatorit ekonomik ne ofertën e tyre:

LISTA E STAFIT PROFESIONAL

NR	EMRI MBIEMRI	PROFESIONI
1	NUHI NUHIU	ING KONSTRUKTIV
2	ARBERESHA KASTRATI	ING KONSTRKTIV
3	BLERIM BAJRAKTARAJ	ING ARKITEKT
4	SAMI LOKAJ	ING ARKITEKT
5	SHPAT KLAIQI	ING HIDROTEKTNIK
6	BUJAR GJOCAJ	ING ELEKTROTEKNIK
7	FISNIK LOSHI	ING GJEODET
8	RAMADAN GASHI	ING MAKINERISE

HIDRO PROJECT SHPK

Kontrata e punëse e prezantuar për ing.znj.Arbreshë Kastrati

Hidro Project Sh.P.K.

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:
Nr Kontrates: 15

KONTRATË PUNE PËR PROJEKTIN

Numri i Prokurimit: 206-23-6380-5-1-2 - Titulli: *Ndërtimi i QKMF në Istog*

Me këtë Kontratë Sh.p.k. Hidro Project me numër të rexhistrimit të biznesit 810842642, (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi) lidhë:
~~Kontratë pune me:~~
Arbresha Kastrati nga Fush Kosova (në tekstin e mëtejmë: i/e punësuari)

1. Kohëzgjatja e kontratës

I/e punësuari themelon marrëdhënie pune duke filluar nga 24/07/2023 deri ne perfundim te projektit.

Titulli i punës: Ing konstruktiv

Detyrat e punës së punëmarrësit, autorizimet dhe përgjegjësitë janë të përshkruara në shtesë të posaqme e cila është pjesë e kësaj Kontrate.

2. Detajet e punës

I/e punësuari do të kryejë punët në: zyren e Kompanisë në Prishtinë, por sipas nevojës puna do të kryhet edhe në pjesët tjera të Kompanisë apo lokacione tjera. Punëdhënësi siguron të drejtën që sipas nevojës të sistemoj punëmarrësin në ndonjë vend tjetër të punës që i përgjigjet përgaditjes profesionale dhe aftësisë së tij.

3. Paga

Të punësuarit i caktohet paga bazë duke përfshirë edhe shtesat tjera në lartësinë prej 500.00 Euro **Bruto**, e cila paguhet në llogarinë bankare të të punësuarit në fund të çdo muaji kalendarik deri me datën 5 të çdo muaji vijues.

4. Puna jashtë orarit

Për punën nga ky nen, i punësuari do të kompenzohet me ditë të lira. Për formën dhe mënyrën e kompenzimit vendos punëdhënësi.

5. Ndalesat nga paga

Punëdhënësi obligohet të bëjë ndalesën nga paga në emër të tatimit dhe kontributeve për skemat pensionale të obligueshme dhe skemat e tjera tatimore të përcaktuara me Ligj.

I/e punësuari është përgjegjës për kompenzimin e dëmit për punën ose në lidhje me punën, nëse me qëllim ose nga pakujdesia i ka shkaktuar dëm punëdhënësit.
I/e punësuari është përgjegjës edhe për kompenzimin e dëmit, nëse me fajin e tij i ka shkaktuar dëm palës së tretë, dëm për të cilin punëdhënësi e ka kompenzuar.

12. Trajnimi

I/e punësuari është i obliguar që të merrë pjesë në kurse dhe trajnime në Kosovë dhe jashtë Kosovës të cilat i përcakton si të obligueshme punëdhënësi. Mospjesëmarrja pa arsye në këto kurse dhe trajnime paraqet bazë për shkëputjen e njëanëshme të kontratës së punës nga ana e punëdhënësit.

13. Detyra e lojalitetit/mbajtjes së të dhënave

Punëmarrësi është i detyruar të i japë punëdhënësit besnikërinë e plotë. Informacionet në lidhje me funksionimin e veprimtarisë së punëdhënësit dhe degëve të tij janë rreptësisht konfidenciale. Të gjitha informatat në lidhje me Punëdhënësin, që i janë dhënë punëmarrësit para dhe gjatë punësimit duhet të mbahen konfidenciale, edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës.

14. Mosmarrëveshjet

Për kontestet eventuale të moszbatimit të kësaj Kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës në Prishtinë.

15. Nënshkrimi Kjo kontratë do të hyjë në fuqi kur të jetë nënshkruar nga të dyja palët, punëdhënësi dhe punëmarrësi.
Çdo ndryshim, në kushtet e mësipërme të dakorduara, do të bëhet me përpilimin e AMENDAMENTIT TË KONTRATËS SË PUNËSIMIT.

Kontrata e punes është nenshkruar ne dy (2) kopje te njejta ne gjuhen shqipe nga nje kopje se cilen palë.**Kjo kontratë punësimi zëvendëson cdo dhe te gjitha marrëveshjet e mëposhme verbale dhe ose marrëvedhjet me shkrim dhe ose kontraten me Punëdhënësin.**

Kopja e ligjit te punës Nr. 03/L-212 do të vihet në dispozicion, sipas nevojës.
Vendimet e marra nga Drejtori Menaxhues i Punëdhënësit janë përfundimtare.
Unë konfirmojë se e kuptojë dhe pranojë ofertën e punësimit në kushtet që përmban kjo Kontratë e Punësimit."

HIDRO PROJECT SHPK

HIDRO PROJECT SH.P.K. PRISHTINË

Për punëmarresin

Diploma Universitare e ing.znj.Arbëresha Kastrati

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

me autoritetin e tij ligjor,
me rekomandimin e
Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

i jep Znj.

Arbëresha Milaim Kastrati

lindur në Maxharë, Kosovë, më 07.07.1990
me Nr. të diplomës BACHELOR: 952

Diplomë MASTER I SHKENCAVE

në Inxhinieri NDËRTIMI
Profili: Strukturist

pas përfundimit me sukses të studimeve universitare të ciklit të dytë
me kohë të plotë në programin mësimor parashikuar për këte diplomë.

Data e lëshimit të diplomës:	30.04.2018
Data e mbrojtjes së diplomës:	20.03.2018
Numër diplome:	M-1050
Numër amze:	PO582B030046

DEKANI:
Prof. Asoc. Gëzim HASKO

1951 1991 UPT

REKTORI:
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

Operatori ekonomik gjatë paraqitjes se kërkesës për rishqyrtim si dëshmi ka apraqitur dokumentet e kërkuara për ing.znj.Arbëresha Kastrati dhe te cilat gjendja ekzistuese e tyre është para publikimit te Njoftimit për Kontratë.

Certifikata e ing.znj.Arbëresha Kastrati për efiçiencë te energjis e dërguar si dëshmi me kërkesën për riqshqyrtim nga ana e OE-së.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT
MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA E KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Universiteti i Prishtinës Universit
"Hasan Prishtina" "Hasan Pr

QENDRA PËR ENERGJI DHE QËNDRU
CENTER FOR ENERGY AND SUSTAI

CERTIFIKATË

Arbëresha Kastrati

Përfundoj me sukses trajnimin për Auditor lidhur me

Auditimin e energjisë në ndërtesa

në Prishtinë, në periudhën 28 Shtator deri më 09 dhjetor 2020

Trajnimi është financuar nga Qeveria Gjermane nëpërmjet Deutsche Gesellsch
Interantionale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

AK me daten 10.10.2023 me anë te letres standarde për sqarime ka kërkuar infomacione shtesë nga ana e OE-së lidhur me ISO Standarde ku ka kërkuar sqarim si ne vijim:

Ne NJK dhe DT tek Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale, me kriterin nr. 4 është kërkuar:

- ISO 9001 - certifikatë valide për sistemin e menaxhimit të cilësisë
- ISO 14001 - certifikatë valide për sistemin e menaxhimit të mjedisit
- ISO 45001 - certificate valid per sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë

Duke marre parasysh se ne ofertën tuaj anëtar i konzerciumit HIDROPROJEKT nuk ka ofruar certifikatat ISO 9001;2015. Ndërsa anëtari tjetër i grupit ENGRUP nuk ka ofruar ISO 14001;2015 dhe ISO 45001;2018. kërkojmë te na i ofroni certifikatat e lartcekura, ne afat kohore brenda 2 ditëve (por mundësisht sa me shpejtë qe keni mundësi).

Kërkesa behet ne baze te nenit 26.6 te rregullores se prokurimit publik, i cili nen përcakton;

Por NUK kanë kërkuar sqarime lidhur me kërkesat **Certifikata për efiçence të energjisë, CV-t e nënshkruara nga vet inxhinieret,Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës, si rezultat i të cilave edhe është eliminuar operatori ekonomik ne Fazen e parë me që rast është atakuar Neni 72 i LPP-së.**

Bazuar dhe mbështetur ne legjislacionin ne fuqi te prokurimit publik ne cilesin e ekspertit shqyrtues konstatoj se gjatë vleresimit, krahasimit dhe ekzaminimit te ofertave AK me rastin e eliminimit te operatorit ekonomik ankues ka vepruar ne kundershtim me **Nenin 72 te LPP-së, Nenin 38 te RrOUP-së Nr.001/2022 dhe Nenin 10 te RrOUP Nr.001/2023** pasi që nuk janë kërkuar sqarime lidhur me këtë dhe ka ndikuar ne eliminimin e ofertës se OE-së

Neni 72 i LPP për këto raste thekëson: - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e

tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Nenin 38 i RrOUP-së Nr.001/2022 thekëson: 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyreobjektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnëgjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë edorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjesekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, çertifkatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE.

Nenin apo pika 10 e RrOUP Nr.001/2023 thekëson:

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 ***Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së***

Mungon Certifikata e TVSH	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e numrit fiskal	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon licenca	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon certifikata ISO	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Mungon çmimi	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Duke pasur parasysh faktet dhe argumentet e prezantuar dhe legjislacionin ne fuqi ne cilesin e ekspertit shqyrtues pretendimin ankimore te OE marrë si te bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ekpserti shqyrtues gjat shqyrtimit te procedures dhe shqyrtimit te pretendimit ankimore konstaton se AK është dashur qe te kërkoj sqarime shtesë ne kuptim dhe zbatim te Nenit 72 te LPP, Nenit 38 te RrRoup nr.001/2022 dhe Nenit 10 te RrOUP Nr.001/2023 ne bazë të kësaj dhe me qëllim te respektimit te LPP-së kërkoj nga PSH.OSHP që te Aprovoj ankesën e operatorit ekonomik dhe te kthehet procedura ne rivleresim

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **HIDRO PROJECT SH.P.K.**

Lulzim Bajrami